

AKT THEMELIMI

"ALBENECON" Sh.p.k.

Sot më datë 29 Gusht 2018, në Tiranë, **Z. Andi Sulejman Zhugli**, i datëlindjes 24-07-1971, lindur dhe banues në Tiranë, person fizik, hartoit Aktin e Themelimit të shoqërisë **"ALBENECON" sh.p.k.** si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria **"ALBENECON" Sh.p.k.**, nga këtu e më poshtë referuar si shoqëria, është themeluar në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar", shkurtimisht SH.P.K.

2. Themeluesi

Shoqëria është themeluar nga Andi Zhugli me numër personal identifikimi **H10724036L**

3. Fusha e veprimtarisë

Fusha e veprimtarisë të shoqërisë **"ALBENECON" sh.p.k.** do të jetë:

- Konsulenca dhe projekte me inxhinierike në fushën e Energjisë, Ndërtimit, dhe Mekanike
- Menaxhim i projekteve të ndryshme në fushën e Energjisë dhe Ndërtimit
- Ndërtimi i objekteve rezidenciale dhe industriale
- Konsulenca dhe assistencë në përgatitjen dhe implementimin e sistemeve ISO të administrimit të cilësisë, sigurisë, mjedisit, energjisë etj për organizatat dhe kompanitë publike dhe private mbështetur me certifikata përkatëse;
- Vlerësimi të Ndkimeve Mjedisore dhe Sociale të Projekteve
- Menaxhim i Veprimtarive Prodhuese
- Assistencë në hartimin e studimeve dhe projekteve kombëtare, europiane dhe ndërkombëtare në fushën e energjisë, ndërtimit dhe infrastrukturave energjetike dhe ndërtimore;
- Asistencë për organizatat e huaja dhe kompanitë private në procesin e hapjes së filialeve të biznesit në Shqipëri;
- Hartimi dhe zbatimi i masave për kursimin dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë,
- Këshillime për studime, zhvillimin dhe administrimin e procesit të cilësisë;
- Trajnimë për zhvillimin e vazhdueshëm profesional;
- Trajnimë në fushën e eficiencës së energjisë
- Përkthime dhe specifikime teknike në fushën e energjisë, ndërtimit, dhe infrastrukturës;

- Kryerja e analizave dhe studimi i procesit të prodhimit për optimizimin dhe eficencën e procesit të prodhimit;
- Këshillime për zbatimin e proceseve të reja në treg për qëllim të administrimit me standarte të procesit dhe cilësisë së produkteve në përputhje me standartet europiane dhe ato ndërkombëtare;
- Trajnine specifike për personelin e kompanisë lidhur me administrimin e cilësisë së produkteve dhe proceseve;
- Hartimi, prodhimi dhe ofrimi i trajnimeve dhe kurseve nëpërmjet video konferencave ose metodologjisë e-learning.
- Çdo lloj tjetër veprimtarie e ligjshme e ngashme me sa më sipër që konsiderohet fitimprurëse për shoqërinë.

Të gjitha veprimtaritë e mësipërme kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë “ALBENECON” sh.p.k. do të jetë në Tiranë, në adresën: **Rr. Todi Shkurti Nr. 15, banesë private, Tiranë**.

Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “ALBENECON” sh.p.k. është 1,000 Lek, e ndarë në një kuotë me vlerë nominale 1,000 Lek, e zotëruar 100% nga ortaku i vetëm Andi Zhugli.

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga themeluesi.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Themeluesit**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt notarial.

7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Administratori i shoqërisë “ALBENECON” sh.p.k. është Z. Andi **Zhugli**. Çdo kontratë do të nënshkruhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues ligjor i pajisur me prokurë të posaçme.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “ALBENECON” sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

8. Shërbime nga të tretë


Shoqëria mund të punësojë individë të jashtëm bazuar në kontrata afatshkurtra ose afatgjata, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shoqëria do të kompensojë shërbimet e tyre sipas kushteve të dakordësuara në kontratat përkatëse. Të ardhurat neto të shoqërisë i takojne ortakut të vetëm.

9. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, ose forca madhore që nuk varen nga vullneti i administratorit të shoqërisë.

Ky Akti Themeli u përpilua në 2 kopje, per t'ju dorëzuar organeve kompetente. Një kopje e këtij dokumenti mbahet nga “ALBENECON” sh.p.k.

Administratori i ALBENECON Sh.p.k.



Data: 29 - 08 - 2018